



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

| | | |
|---|------------------------------|---|
| REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË | | UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË |
| REKTORATI | | |
| Nr./Br./No. 694 | Nr. i faq/ Br. str/ No. pg 1 | |
| Data / Datum / Date: 02.04.2025 Pejë / Pec | | |

Senati

Ref. Nr.

Pejë, 01.04.2025

Në bazë të nenit 42, 45 dhe 48 të Statutit të UHZ-së, Senati i UHZ në mbledhjen e mbajtur me dt.01.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Për vazhdimin e kohëzgjatjes së afatit për përfundimin e studimeve për studentët e niveli të studimeve baçelor dhe master të cilët e kanë kaluar periudhën e lejuar të kohëzgjatjes së rregullt të studimeve

- I. Të gjithë studentëve të cilët i kanë përfunduar të gjitha provimet, u vazhdohet periudha e diplomimit, respektivisht mbrojtjes së temës së diplomës deri më dt. 30.09.2026. Studentët që ndodhen në këtë fazë duhet të kryejnë regjistrimin e semestrave për vitin akademik.
- II. Studentëve të niveli baçelor dhe master që kanë kaluar dyfishin e kohëzgjatjes së rregullt të studimeve, kanë dëgjuar ligjëratat e vitit të dytë të studimeve ose vitit të parë të studimeve të nivelit master me sistem një vjeçar, mirëpo nuk i kanë përfunduar të gjitha provimet e parapara në programet në të cilat studimet përfundojnë me mbrojtje të temës së punimit të diplomës ose në programet ku studimet përfundojnë pa punimi të diplomës, ndërsa fakulteti përkatës nuk i ofron këto studime me programe të reja studimore, u mundësohet vazhdimi i studimeve sipas plan- programit të ri të studimeve pa pasur nevojë aplikimi përmes konkursit publik.
- III. Në qoftë se planprogrami valid në kohën e regjistrimit të parë të studentit nuk zhvillohet në vitin vijues të regjistrimit të studentit, komisioni i studimeve i njësisë akademike vendos për provimet diferenciale ose për obligimet e tjera shtesë si kusht për vazhdimin e studimeve në plan-programin e ri të studimeve.
- IV. Periudha e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt në bazë të nenit 148 të Statuti nuk llogaritet në kohëzgjatjen e studimeve.
- V. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi janë menaxhmenti dhe njësitë akademike.
- VI. Obligohen njësitë akademike dhe zyra e IT që këtë vendim gjatë vitit akademik 2025/26 ta publikojnë dy herë në tabelat e shpalljeve në njësitë përkatëse akademike dhe ueb faqen e UHZ-së.
- VII. Pika II dhe III e këtij vendim vlen vetëm për programet aktuale.
- VIII. Ky vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit në Senat dhe vlen për vitin akademik 2025/26.

Kryesues i Senatit
Prof. Dr. Armand Krasniqi

Vendimi t'i dërgohet: Menaxhmentit të UHZ-së, U.d. Sekretarit të UHZ-së, Dekanëve të njësive akademike, Sekretarëve të njësive akademike, Drejtorit për çështje studentore, Zyrtarëve për çështje studentore, Zyrës së IT, Arkivit të UHZ-së.